



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2021

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

[Data: 15/11/2021]

Drejtuar:

**OPERATORIT EKONOMIK  
“GECI”**

**TIRANE Tirana International Hotel, Sheshi Skënderbej, Nr.8, Tirane**

**Procedura e prokurimit/lotit:** *E Hapur –Mbi kufirin e lartë Monetar - prokurim me mjete elektronike”*

**Numri i procedurës / referenca e Lotit :** REF-05431-09-15-2021

**Përshkrimi i shkurtër i kontratës:** “Ndërtim rruga Porto Romano Durrës, Loti 3 (vazhdimi)”

**Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës:** 1.247.681.404,85 (një miliard e dyqind e dyzet e shtatë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind e katër presje tetëdhjetë e pesë) Lekë, pa TVSH/ 10.261.381,73 EUR pa TVSH (kursit i këmbimit, 1 (një) Euro këmbëhet me 121.59 Lekë) **Kohëzgjatja:** 18 Muaj

**Publikimet e mëparshme :** Buletini i Njoftimeve Publike: *Datë 20 Shtator 2021 [Nr.140]*

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto ☒ X

oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim ☐

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. “ALB BUILDING”**

**J69102508C**

Vlera: **736,913,771** (shtateqind e tridhjetë e gjashtë milion e nënateqind e trembëdhjetë mijë e shtateqind e shtatëdhjetë e një) **lekë pa TVSH.**

**2. “Trema Engineering 2 & ELMAZAJ KONSTRUKSION & RRUGA URA  
ASFALTIM NR.2 ELBASAN” K21401004R L33229401T J62904264O**

Vlera: **850,589,824** (teteqind e pesëdhjetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e teteqind e njëzet e katër) **lekë pa TVSH.**

**3. “PE - VLA - KU & KUPA” K61716013M K51615512C**

Vlera: **1,012,758,583** (një miliard e dymbëdhjetë milion e shtateqind e pesëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tre) **lekë pa TVSH.**

**4. “ALB - STAR” J62903512W**

Vlera : **1,107,418,195** (një miliard e njëqind e shtatë milion e katërqind e tetëmbëdhjetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë) **lekë pa TVSH.**

**5. “A. N. K.” J92408001N**

Vlera : **1,236,692,534** (një miliard e dyqind e tridhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e pesëqind e tridhjetë e katër) **lekë pa TVSH.**

**6. “FUSHA” J61922018S**

Vlera: **1,241,085,698** (një miliard e dyqind e dyzet e një milion e tetëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë) **lekë pa TVSH.**

**7. “4 A-M” K92005016L**

Vlera: **1,241,412,593** (një miliard e dyqind e dyzet e një milion e katërqind e dymbëdhjetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tre) **lekë pa TVSH.**

**8. “GECI” K71829801O**

Vlera : **1,175,927,028** (një miliard e njëqind e shtatëdhjetë e pesë milion e nënateqind e njëzet e shtatë milion e njëzet e tetë) **lekë pa TVSH.**

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- I. Operatori Ekonomik “Albuilding” shpk, **skualifikohet** pasi oferta e paraqitur është anomalisht e ulët. Për këtë arsye nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave më datë 04.11.2021 janë kërkuar analizat e cmimeve të ofruara në përputhje me nenin 93 të Ligjit 162/2020.

Më datë 08.11.2021 nga Operatori Ekonomik janë paraqitur analizat e cmimeve të cilat mbas verifikimit rezultojnë si më poshtë:

**1. Në 3/210 Shtresë cakulli mbeturine qur kave  $t=15$  cm/m 2 përhapur dhe ngjeshur me makineri:**

Sipas manualit normativa e fuqisë punëtore e parashikuar në manual (specialist+punëtori) është 0.21 ndërkohë në analizën e cmimeve të paraqitura nga ana Juaj është 0.06

Greideri për të realizuar shtresën e cakullit 15 cm në analizën e manualit të miratuar duhen 0.023 orë pune për të cilën në analizën e cmimeve të paraqitura nga ana juaj është 0.004

Rruli me vibrim në analizën e manualit të miratuar duhen 0.24 orë pune për të cilën në analizën e cmimeve të paraqitura nga ana juaj është 0.002

Të gjitha këto normativa janë jashtë manualit të miratuar i cili parashikon kohën minimale për realizimin e këtij zëri pune. Për sa i përket normativave nuk mund të ndryshohen, ndryshe nga cmimet që ju mund të ofertoni.

Sipas analizës të paraqitur nga ana juaj Cakëll transporti sipas llogarive të manualit për 10 km duhet të jetë 3.06 , normativa të cilat nuk mund të ndryshohen ,ndërkohë ju keni paraqitur 35 për transportin.

Duke bërë edhe veprimet aritmetike 35x14 sipas analizës të paraqitur nga ana Juaj është 490, ndërkohë në rreshtin e shumatores totali për transportin e manualit është 73.5. Në total cmimi njësi për këtë zë sipas llogaritjeve të analizës së cmimit të paraqitur nga ana juaj **nuk është 160 lek/m<sup>2</sup> por është 622 lek/m<sup>2</sup>.**

**Mos respektimi i normativave të analizës teknike të cmimit të zërit të punës tregon mosrealizimin e zërit të punës me cilësi dhe sipas standarteve teknike.**

**2.Në 3.212/c Shtresë stabilizanti  $t=15$  cm**

Sipas manualit normativa e fuqisë punëtore e parashikuar në manual (specialist+punëtori) është 0.1 ndërkohë në analizën e cmimeve të paraqitura nga ana Juaj është 0.06

Greideri për të realizuar shtresën e cakullit 15 cm në analizën e manualit të miratuar duhen 0.02 orë pune për të cilën në analizën e cmimeve të paraqitura nga ana juaj është 0.004

Rruli me vibrim në analizën e manualit të miratuar duhen 0.05 orë pune për të cilën në analizën e cmimeve të paraqitura nga ana juaj është 0.002

Autobot uji në analizën e manualit të miratuar duhen 0.02 ore pune për të cilën në analizën e cmimeve të paraqitura nga ana juaj është 0.004

Të gjitha këto normativa janë jashtë manualit të miratuar i cili parashikon kohën minimale për realizimin e këtij zëri pune. Për sa i përket normativave nuk mund të ndryshohen, ndryshe nga cmimet që ju mund të ofertoni.

Sipas analizës të paraqitur nga ana juaj Stabilizant transporti sipas llogarive të manualit për 10 km duhet të jetë 3.6,ndërkohë ju keni paraqitur 35 për transportin.

Duke bërë edhe veprimet aritmetike  $35 \times 14$  sipas analizës të paraqitur nga ana Juaj është 490, ndërkohë në rreshtin e shumatores totali për transportin e manualit është 73.5. Në total cmimi njësi për këtë zë sipas llogaritjeve të analizës së cmimit të paraqitur nga ana juaj **nuk është 250 lek/m<sup>2</sup> por është 707 lek/m<sup>2</sup>.**

**Mos respektimi i normativave të analizës teknike të cmimit të zërit të punës tregon mosrealizimin e zërit të punës me cilësi dhe sipas standarteve teknike.**

### **3.Në 3.212/b Shtresë stabilizanti $t=10$ cm**

Sipas manualit normativa e fuqisë punëtore e parashikuar në manual (specialist+punetori) është 0.075 ndërkohë në analizën e cmimeve të paraqitura nga ana Juaj është 0.04

Greideri për të realizuar shtresën e cakullit 15 cm në analizën e manualit të miratuar duhen 0.015 orë pune për të cilën në analizën e cmimeve të paraqitura nga ana juaj është 0.004

Rruli me vibrim në analizën e manualit të miratuar duhen 0.04 orë pune për të cilën në analizën e cmimeve të paraqitura nga ana juaj është 0.002

Autobot uji në analizën e manualit të miratuar duhen 0.02 ore pune për të cilën në analizën e cmimeve të paraqitura nga ana juaj është 0.004

Të gjitha këto normativa janë jashtë manualit të miratuar i cili parashikon kohën minimale për realizimin e këtij zëri pune. Për sa i përket normativave nuk mund të ndryshohen, ndryshe nga cmimet që ju mund të ofertoni.

Sipas analizës të paraqitur nga ana juaj Stabilizant transporti sipas llogarive të manualit për 10 km duhet të jetë 2.34,ndërkohë ju keni paraqitur 35 për transportin.

Duke bërë edhe veprimet aritmetike  $35 \times 14$  sipas analizës të paraqitur nga ana Juaj është 490, ndërkohë në rreshtin e shumatores totali për transportin e manualit është 49. Në total cmimi njësi për këtë zë sipas llogaritjeve të analizës së cmimit të paraqitur nga ana juaj **nuk është 200 lek/m<sup>2</sup> por është 765 lek/m<sup>2</sup>.**

**Mos respektimi i normativave të analizës teknike të cmimit të zërit të punës tregon mosrealizimin e zërit të punës me cilësi dhe sipas standarteve teknike.**

### **4.Në 3.212/1a Shtresë konglomerati $t=10$ cm**

Janë respektuar normativat e analizës së manualit

Sipas analizës të paraqitur nga ana juaj konglomerat transporti sipas llogarive të manualit për 10 km duhet të jetë 3.3,ndërkohë ju keni paraqitur 28 për transportin. Duke bërë edhe veprimet aritmetike  $28 \times 14$  sipas analizës të paraqitur nga ana Juaj është 392, ndërkohë në rreshtin e shumatores totali për transportin e manualit është 39.2.

Ndërkohë në analizën tuaj në të cilën janë shpenzimet plotësuese 8 % dhe fitimi 10 % si vlerë fitimi shifra 326 nuk i korespondon fitimit 10 % por fitimit 29 %.

Në total cmimi njësi për këtë zë duke ju referuar transportit 392 sipas llogaritjeve të analizës cmimi pa shpenzimet plotësuese dhe fitimi nuk është 1114 por 1467.4. Si rezultat cmimi i paraqitur nga ana juaj duke përfshirë shpenzimet plotësuese 8 % dhe fitimin e deklaruar 10 % **nuk është 1530 lek/m<sup>2</sup> por është 1731.5 lek/m<sup>2</sup>.**

**Mos respektimi i normativave të analizës teknike të cmimit të zërit të punës tregon mosrealizimin e zërit të punës me cilësi dhe sipas standarteve teknike.**

**5. Në 3.222/2 Shtresë binderi me granil qur kave 6cm me makineri**

Janë respektuar normativat e analizës së manualit

Sipas analizës të paraqitur nga ana juaj binder transporti sipas llogarive të manualit për 10 km duhet të jetë 2.64, ndërkohë ju keni paraqitur 28 për transportin. Duke bërë edhe veprimet aritmetike  $28 \times 14$  sipas analizës të paraqitur nga ana juaj është 392, ndërkohë në rreshtin e shumatores totali për transportin e manualit është 23.52.

Në total cmimi njësi për këtë zë duke ju referuar transportit 392 sipas llogaritjeve të analizës cmimi pa shpenzimet plotësuese dhe fitimi nuk është 729 por 1096.9. Si rezultat cmimi i paraqitur nga ana juaj duke përfshirë shpenzimet plotësuese 8 % dhe fitimin e deklaruar 50 % **nuk është 1150 lek/m<sup>2</sup> por është 1733.1 lek/m<sup>2</sup>.**

**6. Në An11 F.V Guardrail H2 anësore me 3 valezime në një anë, W4**

Janë respektuar normativat e analizës së manualit. Sipas llogaritjeve të analizës shpenzimet plotësuese të deklaruara 8 % nuk janë 351.5 por 374.96 . Si rezultat cmimi i paraqitur nga ana juaj **nuk është 5038 lek/copë por është 5691.96 lek/copë.**

Ndërkohë në preventivin e paraqitur nga operatori për këtë zë është paraqitur cmimi 5000 lek/copë, ndërsa në analizën e cmimeve është paraqitur 5038 lek/copë.

**7. Në An4 F.V Guardrail H1 anësore me 2 valëzime në një anë, W4**

Janë respektuar normativat e analizës së manualit. Sipas llogaritjeve zëri material  $1 \times 4633$  nga analiza e paraqitur nga ana juaj rezulton me gabim (  $1 \times 4633 = 2732$ ). Llogaritja e saktë është  $1 \times 4633 = 4633$

Si rezultat cmimi i paraqitur nga ana juaj **nuk është 4000 lek/copë por është 6189 lek/copë.**

**8. Për zërat e analizave të paraqitura më poshtë ka mos përputhje midis cmimit të paraqitur në preventiv dhe cmimit në analizën e cmimeve të paraqitur nga ju, konkretisht:**

- **Germim dheu me ekskavator zingjir, 1.0 m<sup>3</sup>, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet.** Në preventivin e paraqitur nga operatori për këtë zë është paraqitur cmimi 200 lek/m<sup>3</sup>, ndërsa në analizën e cmimeve është paraqitur 194 lek/m<sup>3</sup>.

-**Struktura monolite betoni C25/30** .Në preventivin e paraqitur nga operatori për këtë zë është paraqitur cmimi 9800 lek/m<sup>3</sup>, ndërsa në analizën e cmimeve është paraqitur 9830 lek/m<sup>3</sup>.

-**Struktura monolite betoni me cakell C30/37** Në preventivin e paraqitur nga operatori për këtë zë është paraqitur cmimi 10200 lek/m<sup>3</sup>, ndërsa në analizën e cmimeve është paraqitur 10237 lek/m<sup>3</sup>.

**-Struktura monolite betoni C20/25 ( per kuneten)** Në preventivin e paraqitur nga operatori për këtë zë është paraqitur cmimi 11200 lek/m<sup>3</sup>, ndërsa në analizën e cmimeve është paraqitur 11263 lek/m<sup>3</sup>.

**-F.V Hekur gershet  $f_{cm}=1860$ dan/cm<sup>2</sup>** Në preventivin e paraqitur nga operatori për këtë zë është paraqitur cmimi 250,000 lek/ton, ndërsa në analizën e cmimeve është paraqitur 250,035.46 lek/ton.

**-Ngritja dhe montimi i elementeve te paraperg.( traret e urave) L-26m.** Në preventivin e paraqitur nga operatori për këtë zë është paraqitur cmimi 35000 lek/cope, ndërsa në analizën e cmimeve është paraqitur 35293 lek/cope.

**-F.V krah shtylla metalike KRH-MSI 1500/1500/10** Në preventivin e paraqitur nga operatori për këtë zë është paraqitur cmimi 3500 lek/cope, ndërsa në analizën e cmimeve është paraqitur 3756 lek/cope.

## **9. Nuk janë paraqitur analiza cmimi për zërat e mëposhtëm:**

- F.V panele anesore te urave B/A ( te parapergatitur)
- F.V panele te parafabrikuar B/A per derdhien e soletes mbi trare
- F.V ndricues LED 150W
- F.V Prozhektor LED 100W
- F.V morseteri shtylle 3P+sig.8a+kapak
- F.V percjellesa CU te izoluar me gome, per ndricim ne tubot e vendosur me pare,seksion 16.0 mm<sup>2</sup>
- F.V percjellesa CU te izoluar me gome, per ndricim ne tubot e vendosur me pare,seksion 4x10.0 mm<sup>2</sup>
- F.V percjellesa CU te izoluar me gome, per ndricim ne tubot e vendosur me pare,seksion 4x6.0 mm<sup>2</sup>
- F.V percjellesa CU te izoluar me gome, per ndricim ne tubot e vendosur me pare,seksion 4x4.0 mm<sup>2</sup>
- F.V percjellesa CU te izoluar me gome, per ndricim ne tubot e vendosur me pare,seksion 3x1.5 mm<sup>2</sup>
- F.V percjellesa CU te izoluar me gome, per ndricim ne tubot e vendosur me pare,seksion 16 mm<sup>2</sup>
- F.V Kabine box parafabrikat 2L+1TR - (box parafabrikat perfshin: kabinen parafabrikat me permasa 4.2X2.2, h=2.2m, bazamentin e kabines 4.2X2.2, h=0.6m, setin e pajisjeve TM / TU, tokezimi i brendshem, ndricimi, tapet dielektrik, tabela sig.teknik, urat TM dhe TU me transformatorin e fuqise )

**Për sa më sipër, referuar të gjithë materialit të paraqitur Operatori ekonomik nuk provon realizimin e kontrates me keto cmime pasi në paraqitjen e analizave rezultojnë mos respektim të normativave të formatit të analizave të manualit në fuqi , gabime të**

ndryshme të veprimeve artimetike , mos perputhje të cmimit të ofertuar me analizat e paraqitura si dhe nuk janë paraqitur të gjitha analizat e zërave të punës sipas preventivit

**II. Skualifikohet oferta e paraqitur nga bashkimi i operatoreve ekonomik “Trema Engineering & Rruga Ura nr. 2 Elbasan & Elmazaj Konstruksion sh.p.k pasi nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të saktë dhe të plotë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të përcaktuara në DST, konkretisht :**

- Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.1 **Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme**

**Operatori ekonomik “Trema Engineering”** Nuk ka plotësuar Kriterin për Punët e Ngjashme pasi, bazuar në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit pika 2.1 / C “Dokumentet e lëshuara nga autoritete publike në juridiksione të tjera, dhe dokumentet e vërtetuara nga një noter publik në juridiksione të tjera duhet të legalizohen sipas Konventës së Hagës për Vulën Apostile, të datës 05.10.1961”

- Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.2 *Operatorët ekonomike duhet të disponojnë licensat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën perkatese të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. **Shqyrtimi i licensave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër.** Licensa profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme. [...]*

Për të plotësuar këtë kriter nga Trema Engineering shpk & Rruga Ura nr. 2 Elbasan sha & Elmazaj Konstruksion shpk, janë dorëzuar licensat perkatese të shoqërive. Nga kontrolli i tyre repektivisht rezultojnë që:

1. Operatori Elmazaj Konstruksion shpk, midis të tjerëve rezultojnë të ketë si drejtues teknik të shoqërisë:
    - *Adriatik Omeri, drejtues teknik si Gjeometër gjeodezie, subjekt i cili rezultojnë të jetë i punësuar me kohë të plotë pranë Bashkisë Elbasan.*
- Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.8. **Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:**

Nga BOE ne formularin e vetdeklarimit sipas Shtojces 8 nuk jane paraqitur mjetet \*Rul gome gome mbi 14 ton , \*Trencher për hapje kanali me fuqi 240 HP sipas kërkeses se DST Gjithashtu per disa mjete te tjera si Greider, Minieskavatore, Buldozer (traktor) nuk jane paraqitur te dhena reference.

**III. Skualifikohet oferta e paraqitur nga bashkimi i operatoreve ekonomik “PE – VLA - KU & Biba X & Kupa” sh.p.k pasi nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të saktë dhe të plotë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të përcaktuara në DST, konkretisht :**

- Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.2 te kriterëve te vecanta per kualifikim eshte kerkuar; ... 2.3.2 *Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. **Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa me sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme. [...]***

Per te plotësuar kete kriter nga PE – VLA - KU shpk & Biba X shpk & Kupa shpk, jane dorezuar licencat perkatëse te shoqërive. Nga kontrolli i tyre repektivisht rezulton qe:

1. Operatori PE – VLA - KU shpk midis te tjereve rezulton te kete si drejtues teknik te shoqërisë:
    - Sokol Qehajaj, drejtues teknik si Inxhinier për ndërtimin e rrugëve dhe autostradave, subjekt i cili rezulton te jete i punesuar me kohe te plote prane Bashkia e Tiranës si Inspektor i policisë ndërtimore.
  2. Operatori Biba X shpk, midis te tjereve rezulton te kete si drejtues teknik te shoqërisë:
    - Arbana Kola, drejtues teknik si Inxhinier mjedisi, subjekt i cili rezulton te jete i punesuar me kohe te plote prane Shoq.Ujesjelles Kanalizime te Shqiperise si Koordinator.
  3. Operatori Kupa shpk, midis te tjereve rezulton te kete si drejtues teknik te shoqërisë:
    - Olta Shijaku Beti, drejtues teknik si Inxhinier hidro, subjekt i cili rezulton te jete i punesuar me kohe te plote prane Ujësjiellës Kanalizime Tiranë, si Inxhinier ndërtimi / mjedis trajtim ujërash.
- Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.1 **Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme**

a) punë të ngjashme **për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit**, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, **ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.**

**Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.**

*Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesmarje në bashkim, vendosin me marveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të permbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Puna e ngjashme e paraqitur nga Bashkimi i Operatoreve ekonomik konkretisht "Biba X" shpk dhe "Kupa" shpk nuk ploteson përqindjen pjesmarrese te secilit ne kete bashkim operatoresh.

#### **IV. *Skualifikohet oferta e paraqitur nga operatori ekonomik "ALBSTAR" sh.p.k pasi nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të saktë dhe të plotë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të përcaktuara në DST, konkretisht :***

- Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.5 Operatori ekonomik pjesmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë personelin kryesor dhe mbështetës, drejtues teknik në licencën e shoqërisë sipas përcaktimeve në DST

Nga Operatori Ekonomik stafi teknik dhe profesional i deklaruar i disponueshem per realizimin e kesaj kontrate ne kete procedure prokurimi janë të deklaruara në një objekt tjetër për të cilën ky Operator është shpall fitues pranë Autoritetit Kontraktor. Bazuar në Dokumentat Standarte të Tenderit, dhe në Deklaratën e Operatorit *\*stafi teknik i shoqerise dhe stafi profesional i deklaruar i Operatorit nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara në procedura të shpallura fitues*".

- Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.8 Operatori ekonomik pjesmarrës, për realizimin e kontratës duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme sipas përcaktimeve në DST

Nga Operatori Ekonomik në deklaratën e paraqitur për disponimin e mjeteve / pajisjeve / makinerive të nevojshme për realizimin e këtij objekti disa nga makineritë janë të deklaruara në një objekt tjetër për të cilën ky Operator është shpall fitues pranë Autoritetit Kontraktor. Bazuar në Dokumentat Standarte të Tenderit, dhe në Deklaratën e Operatorit *\*makineritë e*

*Operatorit nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruar në procedura të shpallura fitues”.*

**V. Skualifikohet oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “A.N.K” sh.p.k pasi nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të saktë dhe të plotë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kritereve të përcaktuara në DST, konkretisht :**

- Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikes 2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme
- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.
- Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikes 2.3.4 dhe 2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë) sipas kërkeses në DST
- Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikes 2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e kërkuara në DST

**VI. Skualifikohet oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “FUSHA” sh.p.k pasi nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të saktë dhe të plotë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kritereve të përcaktuara në DST, konkretisht :**

- Nuk ka paraqitur formularin e sigurimit të ofertes me vlerë **24.953.628,09** (njëzet e katër milion e nëntëqind e pesëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e njëzet e tetë presje zero nëntë) Lekë pa TVSH të kërkuar sipas shtojces Nr.3

**VII. Skualifikohet oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “4A-M” sh.p.k pasi nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të saktë dhe të plotë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kritereve të përcaktuara në DST, konkretisht :**

- Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë personelin kryesor dhe mbështetës, drejtues teknik në licencën e shoqërisë sipas përcaktimeve në DST

Nga Operatori Ekonomik stafi teknik dhe profesional i deklaruar i disponueshem per realizimin e kesaj kontrate ne kete procedure prokurimi janë të deklaruara në një objekt tjetër për të cilën ky Operator është shpall fitues pranë Autoritetit Kontraktor. Bazuar në Dokumentat Standarte të Tenderit, dhe në Deklaratën e Operatorit *\*stafi teknik i shoqerise dhe stafi profesional i deklaruar i Operatorit nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara në procedura të shpallura fitues*”.

- Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikes 2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e kerkuara ne DST

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **OE “GECI” shpk** me adrese: **TIRANE Tirana International Hotel, Sheshi Skënderbej, Nr.8, Tirane**, me NUIS: **K718298010**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej Vlera: **1,175,927,028** (një miliard e njeqind e shtatedhjetë e pese million e nenteqind e njezet e shtate mije e njezet e tete) **lekë pa TVSH**. Totali i pikëve të marra sipas sistemit [258.15], në mesatare pikët e mara janë [86.05] , është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Evis Berberi**